

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

9.01.2023
Ora, 11:57

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për përzgjedhjen e monitoruesve për Bashkinë Tiranë për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. E. Podgorica**
- **Parti Politike:**
- **OJQ:**

Z. Y. Merkaj: Përshëndetje të gjithëve, sot në datën 9.01.2023, është planifikuar dhe janë njoftuar aplikantët për të zhvilluar procedurën e shortit për caktimin e monitoruesve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023, për Bashkinë Tiranë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në vlerësim të rëndësisë dhe transparencës së procesit, në zbatim të udhëzimit nr. 03, datë 03.11.2022, si dhe vendimit nr. 210, datë 30.11.2022 ka përcaktuar numërin e monitoruesve për monitorimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet vendore. Është bërë publik njoftimi në faqen zyrtare të KQZ-së, për pjesëmarrjen e të gjithë aplikantëve që shfaqën interes për të qenë monitorues në fushatën zgjedhore të dt 14 maj 2023. Në përgjigje të njoftimit publik të bërë nga ana jonë kanë depozituar dokumentacionin 32 (tridhjetë e dy) aplikantë të interesuar për monitorues në Bashkinë Tiranë. Pas verifikimeve të dokumentave të dorëzuara nga aplikantët rezulton se 30 (tridhjetë)

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

aplikantë plotësojnë kriteret. Referuar vendimit nr. 210, datë 30.11.2022, “Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”, për Bashkinë Tiranë janë caktuar 21 (njëzet e një) monitorues për të monitoruar fushatën zgjedhore të datë 14 maj 2023. Për sa më sipër nga këto 30 (tridhjetë) aplikimet, 11 (njëmbëdhjetë) kanë qenë pjesë e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021, si dhe zgjedhjeve të pjesshme vendore, të datës 6 mars 2022 dhe duke u bazuar në vendimin nr. 210, datë 30.11.2022, numri që nevojitet për Bashkinë Tiranë është 21 (njëzet e një) monitorues për këtë arsye 11 (njëmbëdhjetë) janë për zgjedhur automatikisht. Shorti do të zhvillohet ndërmjet 19 aplikantëve për 10 (dhjetë) vende monitoruesish. Për këtë arsye procedura e shortit është e njëjtë si dhe herët e kaluara. Në një enë transparente do të vendosen 19 shirita letre me emrat e aplikantëve për monitorues dhe nga këto do të përzgjidhen 10 të parët që do të tërhiqen nga përfaqësuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pas miratimit të listës paraprahe të aplikantëve, janë njoftuar të gjithë aplikantët se sot në datën 9.01.2023 do të realizohet shorti on-line për përzgjedhjen e monitoruesve. Vazhdojmë me leximin e emrave të listës paraprahe të aplikantëve për monitorues për Bashkinë e Tiranës, emri i shkruar në një shirit letre do të futet në një gogël me peshë, ngjyrë dhe madhësi të njëjtë dhe më pas në një enë transparente:

- | | |
|----------------------|----------------------|
| 1. Brunilda Qeva; | 9. Alba Musaj; |
| 2. Greta Haxhistafa; | 10. Nikola Xhumai; |
| 3. Dejvis Toska; | 11. Armigen Minga; |
| 4. And Demneri; | 12. Endi Kalemaj; |
| 5. Iballe Breca; | 13. Xhelisda Zeqiri; |
| 6. Eglantina Hodo; | 14. Alban Feti; |
| 7. Dife Salliu; | 15. Frenki Hajdari; |
| 8. Fabiola Harxhi; | 16. Robert Sinani; |

*Zbardhi materialin audio
Meritq DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.09.01.2023*

17. Anxhela Tafa;

19. Edmond Xhuli.

18. Brunilda Manko;

Këta janë 19 emrat, shiritat e të cilëve u futën në gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njejtë në një enë transparente. Pasi përziejehen nga përfaqësuesi i KQZ-së, tërhiqet gogla e parë:

1. Edmond Xhuli;

6. Eglantina Hodo;

2. Brunilda Manko;

7. Alba Musaj;

3. Xhelisda Zeqiri;

8. Iballe Breca;

4. Armigen Ninga;

9. Frenki Hajdari;

5. Dife Salliu;

10. Dejvis Toska.

Pas përfundimit të procedurës së shortit u zgjodhën dhe 10 monitoruesit të cilët do të monitorojnë fushatën zgjedhore në Bashkinë Tiranë për zgjedhjet e datës 14 maj 2023, ju faleminderit!

Vendimi nr. 10

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

